



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

“PËR

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 559, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR, PËR
VEPRIMTARI EKONOMIKE, SI DHE PËR PRODHIMET DRUSORE DHE
JODRUSORE PYJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të neneve 25, pika 4, dhe 27, pika 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në Shtojcën nr. 3 “tarifat për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 559, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave, bëhet shtesa si më poshtë:

1. Në fund të tabelës 3/1 “Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë”, shtohet fjalia si më poshtë :

“Shënim: Kur drutë e zjarrit janë nxjerrë nga sipërfaqe të djegura, të evidentuara sipas dokumentacionit tekniko-ligjor përkatës, por materiali drusor është i përdorshëm, tarifat për to do të jenë 40% më e të ulëta se tarifat bazë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA